



Ministri Peleshi: Dislokimi i efektivëve të FARSH në Gadishullin e Sinait, event me rëndësi historike

Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi dhe znj. Elizabeth L. Dibble, përfaqësuesja më e lartë e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve (MFO), nënshkruan marrëveshjen midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës Shumëkombëshe Vëzhguese (MFO) për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në

misionin e MFO në Sinai, Republika Arabe e Egjiptit. Misioni i MFO-së është të mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të sigurisë të Traktatit të Paqes midis Egjiptit dhe Izraelit. Marrëveshja e nënshkruar i hap rrugën përfaqësimit të vendit tonë me një personel prej 4 (katër) efektivash të Policisë Ushtarake (PU) në role drejtuese, mbikëqyrëse dhe veprimtari hetimore. Ndër të tjera,

znj. Dibble shprehu mirënjohje për kontributin e vendit tonë në këtë mision dhe vlerësoi përpjekjet e Shqipërisë si eksportuese të sigurisë edhe përtej rajonit. Ministri i Mbrojtjes shprehu dëshirën e qartë politike dhe vendosmëri për përfaqësim dinjitoz të RSH në këtë mision. Dislokimi i efektivëve të FARSH-së në këtë mision është një event me... » faqe 2



“Projektbuxheti i vitit 2023”

Ministri Peleshi:
7 mijë ushtarakë
do të përfitojnë
një rritje të re
të pagës me
buxhetin 2023



Gjeneral brigade Arben Kingji priti në takim
atasheun ushtarak ukrainas, kolonel Dmytro Lukashuk

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në takim atashen ushtarak ukrainas, Kolonel Dmytro Lukashuk, (jo rezident në Shqipëri). Gjeneral Kingji, pasi i uroi mirëseardhjen, e njohu kolonelin Lukashuk me zhvillimet dhe arritjet më të fundit të FARSH-së. Gjatë takimit gjeneral Kingji e siguroi atashen ushtarak ukrainas, kolonel Lukashuk, se Shqipëria do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm duke iu bashkuar çdo nisme dhe kontributi...



Përfundoi kursi 74 Fillestar
i Nënoficerit në QAPN

Në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve u zhvillua ceremonia e certifikimit të kursantëve të Kursit 74 Fillestar të Nënoficerit. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, komandanti i Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, si dhe personeli i QAPN-së. Gjatë kësaj ceremonie përshëndetën komandanti i AFA-së, komandanti i QAPN-së, instruktori përgjegjës i Kursit Fillestar dhe kursanti i kursit fillestar të nënoficerit, i cili përfundoi kursin me rezultate të larta...



Në Qendrën e Mirëmbajtjes së Mjeteve
Ajrore ka filluar trajnimi “On Job Training”

Në Bazën Ajrore Farkë, ka filluar trajnimi praktik “On Job training”, me personelin teknik oficer dhe nënoficer që kryen mirëmbajtjen e mjeteve ajrore në përdorim të Forcës Ajrore. Ky është një trajnim dymujor dhe është hera e parë që kryhet kaq i gjerë, me një numër të madh ushtarakësh në fusha të ndryshme të mirëmbajtjes, përkatësisht për mirëmbajtjen e strukturës, motorit, si dhe pajimeve elektrike/avioni. Trajnimi “On Job training”, ka për qëllim standardizimin e procedurave praktike për...



Gjeneral brigade Arben Kingji priti në takim atasheun ushtarak ukrainas, kolonel Dmytro Lukashuk

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji, priti në takim atasheun ushtarak ukrainas, Kolonel Dmytro Lukashuk, (jo rezident në Shqipëri).

Gjeneral Kingji, pasi i uroi mirëseardhjen, e njohu kolonelin Lukashuk me zhvillimet dhe arritjet më të fundit të FARSH-së.

Gjatë takimit gjeneral Kingji e siguroi atasheun ushtarak ukrainas, kolonel Lukashuk, se Shqipëria do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm duke iu bashkuar çdo nisme dhe kontributi në ndihmë të Ukrainës, në bashkëpunim me SHBA-të, vendet anëtare të NATO-s, si dhe ato partnere.

Nga ana e tij, atasheu ushtarak ukrainas, kolonel Lukashuk shprehu mirënjohjen për mbështetjen dhe bashkëpunimin në fushën e Mbrojtjes mes dy vendeve gjatë kësaj periudhe, duke falënderuar për ndihmën që Forcat e Armatosura dhe Shqipëria kanë dhënë dhe do japin në ndihmë të ushtrisë dhe popullit ukrainas në këtë situatë mjaft të vështirë dhe kritike.

Të dy bashkëbiseduesit shprehën besimin dhe dëshirën e vijimit dhe forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve.



“

SHQIPËRIA DO TË VAZHDOJË TË LUAJË NJË ROL TË RËNDËSISHËM DUKE IU BASHKUAR ÇDO NISME DHE KONTRIBUTI NË NDIHMË TË UKRAINËS, NË BASHKËPUNIM ME SHBA-TË, VENDET ANËTARE TË NATO-S, SI DHE ATO PARTNERE.

Shef i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji viziton Bazën Ajrore të Kuçovës, ku punimet vijojnë me ritme të shpejta për rinovimin dhe ndërtimin e plotë të bazës, e cila do të shërbejë si bazë taktike dhe mbështetëse për NATO-n, dhe si bazë kombëtare për Forcën Ajrore.



"Projektbuxheti i vitit 2023"

Ministri Peleshi: 7 mijë ushtarakë do të përfitojnë një rritje të re të pagës me buxhetin 2023

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi deklaroi gjatë fjalës së tij në seancën plenare të kuvendit, ku u diskutua "Projektbuxheti i vitit 2023", se vitin që vjen parashikohet një tjetër rritje për pagat e të gjithë ushtarakëve.

"Kam një lajm shumë të mirë për shtresën që përfaqësoj, për gjithë ushtarakët, rreth 7 mijë, që do të përfitojnë një rritje të re të pagës me këtë buxhet. Nga korriku ata marrin 30% më shumë pagë, në janar mbi këtë 30% shtohet edhe 7%. Pra është një rritje 40% e pagës. Nëse një ushtarak merrte 50 mijë lekë në 2022, tani do të marrë 70 mijë lekë, kjo është për pagën më të ulët dhe vijon për të gjithë deri në pagat më të larta. Ky është një vizion i qeverisë shqiptare. Kryeministri e ka thënë dhe, po e mbajmë këtë fjalë, që do të rrisim çdo vit pagat e Forcave të Armatosura, pavarësisht se jemi në kushtet e një buxheti rezistence, pra do të rriten çdo vit deri sa të kalojmë vendet e Ballkanit Perëndimor. Pra, pagat të jenë dinjitoze, forcat tona të jenë dinjitoze", - tha ministri Peleshi.



"NËSE NJË USHTARAK MERRTE 50 MIJË LEKË NË 2022, TANI DO TË MARRË 70 MIJË LEKË, KJO ËSHTË PËR PAGËN MË TË ULËT DHE VIJON PËR TË GJITHË DERI NË PAGAT MË TË LARTA".

Shqipëria do të kontribuojë për garantimin e marrëveshjes së paqes në Gadishullin e Sinait, Egjipt

Ministri Peleshi: Dislokimi i efektivëve të FARSH në Gadishullin e Sinait, event me rëndësi historike

Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi dhe znj. Elizabeth L. Dibble, përfaqësuesja më e lartë e Forcës Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve (MFO), nënshkruan marrëveshjen midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës Shumëkombëshe Vëzhguese (MFO) për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e MFO në Sinai, Republika Arabe e Egjiptit.

Misioni i MFO-së është të mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të sigurisë të Traktatit të Paqes midis Egjiptit dhe Izraelit. Marrëveshja e nënshkruar i hap rrugën përfaqësimit të vendit tonë me një personel prej 4 (katër) efektivash të Policisë Ushtarake (PU) në role drejtuese, mbikëqyrëse dhe veprimtari hetimore.

Ndër të tjera, znj. Dibble shprehu mirënjohje për kontributin e vendit tonë në këtë mision dhe vlerësoi përpjekjet e Shqipërisë si eksportuese të sigurisë edhe përtej rajonit. Ministri i Mbrojtjes shprehu dëshirën e qartë politike dhe vendosmëri për përfaqësim dinjitoz të RSH në këtë mision.

Dislokimi i efektivëve të FARSH-së në këtë mision është një event me rëndësi historike, pasi për herë të parë Shqipëria kontribuon me trupa ushtarake për garantimin e marrëveshjes së paqes në Gadishullin e Sinait. Në të njëjtën kohë ky është një kontribut i veçantë për sa i përket bashkëpunimit strategjik në fushën e Mbrojtjes me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



Marrëveshja e nënshkruar i hap rrugën përfaqësimit të vendit tonë me një personel prej 4 (katër) efektivash të Policisë Ushtarake (PU) në role drejtuese, mbikëqyrëse dhe veprimtari hetimore.



PËRFUNDOI KURSI 74 FILLESTAR I NËNOFICERIT NË QAPN

Gjeneral Brigade Bilbil Bitri: Ky kurs për ju është guri i parë kilometrik i karrierës suaj ushtarake si nënoficerët e së ardhmes

AFA



Në Qendrën e Arsimimit Profesional të Nënoficerëve u zhvillua ceremonia e certifikimit të kursantëve të Kursit 74 Fillestar të Nënoficerit. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, komandanti i Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, si dhe personeli i QAPN-së.

Gjatë kësaj ceremonie përshëndetën komandanti i AFA-së, komandanti i QAPN-së, instruktori përgjegjës i Kursit Fillestar dhe kursanti i kursit fillestar të nënoficerit, i cili përfundoi kursin me rezultate të larta.

Në fjalën e tij përshëndetëse Komandanti i AFA-së gjeneral brigade Bilbil Bitri në fjalën e tij të rastit ndër të tjera theksoi: “Ky kurs për ju është guri i parë kilometrik i karrierës suaj ushtarake drejt të qenit nënoficerët e së ardhmes, sepse rruga e karrierës suaj është e gjatë, e bukur, e larmishme dhe tepër e rëndësishme. Ju duhet të investoni në vijimësi në dije, arsimim dhe trajnim në mënyrë të vazhdueshme, pasi ju jeni shtylla kurrizore e Forcave të Armatosura”, ndërsa komandanti i QAPN-së, kolonel Arben Toska gjatë fjalës përshëndetëse u shpreh se: “Agresioni ushtarak që ka ndërmarrë Rusia për të pushtuar Ukrainën, një vend Sovran, ka ndryshuar mjedisin e



sigurisë në të gjithë Globin. E solla këtë në vëmendjen tuaj, për faktin e thjeshtë, se të qenit ushtarak, pjesë e NATO-s, ku secili prej nesh që është nën uniformë duhet të jetë i mirë arsimuar, mirë trajnuar, i përgatitur dhe i gatshëm në çdo kohë për të përballuar çdo sfidë dhe kërcënim të mundshëm, së pari për mbrojtjen e sovranitetit tonë por dhe për të dhënë kontribut në kuadër të aleancës”.

Në këtë ceremoni u certifikuan gjithsej 45 kursantë, ku 6 prej tyre personel femër.



Shkëmbim eksperiencash me studentët e Akademisë ushtarake Greke dhe Akademisë së Forcave të Armatosura. Studentët u njohën me aktivitetin stërvitor, më pas zhvilluan vizitë në muzeun e Pavarësisë dhe qytetin historik të Vlorës.

Në Qendrën e Mirëmbajtjes së Mjeteve Ajrore ka filluar trajnimi "On Job Training"

Në Bazën Ajrore Farkë, ka filluar trajnimi praktik "On Job training", me personelin teknik oficer dhe nënoficer që kryen mirëmbajtjen e mjeteve ajrore në përdorim të Forcës Ajrore. Ky është një trajnim dymujor dhe është hera e parë që kryhet kaq i gjerë, me një numër të madh ushtarakësh në fusha të ndryshme të mirëmbajtjes, përkatësisht për mirëmbajtjen e strukturës, motorit, si dhe pajimeve elektrike/avioni.

Trajnimi "On Job training", ka për qëllim standardizimin e procedurave praktike për mirëmbajtjen e mjeteve ajrore.

Metoda e këtij trajnimi është nëpërmjet praktikës së punës të udhëhequr nga një staf teknikësh ushtarakë dhe civil, të trajnuar brenda dhe jashtë vendit, dhe me një eksperiencë të gjatë në aviacion. Kjo praktikë është gjerësisht e aplikuar në njësitë ajrore të vendeve të NATO-s dhe efikase në gërshtimin e njohurive teorike me ato praktike.

Personeli që po trajnohet, në bazë të rezultateve të arritura dhe performancës së treguar do të jetë bërthama e personelit që do të shërbejë në Qendrën e Mirëmbajtjes së Mjeteve Ajrore.



Në QAPN hapet Kursi i 10-të i Kryekapterit

Në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve është hapur kursi i 10-të i Kryekapterit, i përbërë nga 11 kursantë, ku 2 prej tyre janë personel femër.

Kursantët do të ndjekin këtë kurs përgjatë një harku kohor 8-javor, i cili fokusohet në zhvillimin e elementeve themelore të personalitetit të kryekapterit, si këshilltar i komandantit të forcës dhe njësisë dhe detyra të njehsuara me të. Në këtë kurs marrin pjesë nënoficerë me gradën "Kapter".

Kursi i Kryekapterit shënon arritjen e majave të intelektit të një nënoficeri, pasi përbën vendosjen e gurit të fundit kilometrik në karrierën e tij.



Personeli kursant i FSK-së që ndjek Kursin 52 Bazë dhe Kursin 51 të Avancuar, zhvilluan vizita kulturore në qytetin e Beratit, në qytetin e Krujës, në Muzeun Historik Kombëtar dhe në Muzeun e Forcave të Armatosura.



Forcat Tokësore vazhdojnë operacionin për eliminimin e lëndëve plasëse



Në kuadër të operacionit për kërkimin, zbulimin dhe grumbullimin e municioneve të paplasura (UXO), të cilat gjenden në ish-poligonin e qitjes, në zonën e Jub-Sukthit, Njësia Administrative Katund i Ri, Bashkia Durrës, me qëllim kthimin në zonë të sigurt për përdorim nga autoritetet lokale, u zhvillua një takim në terren me efektivet e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, Forca Tokësore (Kompania e Xhenios). Drejtuesi i operacionit shpjegoi rëndësinë që paraqet përfundimi me sukses i këtij operacioni. Puna për pastrimin e zonës, zhvillohet në një hapësirë prej 42 ha, për të cilën është vendosur perimetri i sigurisë. Aktualisht, janë pastruar rreth 8,6 ha. Deri tani, është gjetur një sasi municionesh dhe është bërë e mundur heqja e tyre nga zona. Efektivët e angazhuar në operacion, vijojnë punën me intensitet të lartë. Duke shprehur vlerësimet më të larta për operacionin në terren, Institucioni i Prefektit garanton frymën e bashkëpunimit, mbështetjes në kuadër të ushtrimit të funksioneve dhe detyrave të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore. Gjithashtu, Prefekti i Qarkut kërkon nga ana e banorëve të zonës bashkëpunimin dhe mirëkuptimin për të shmangur lëvizjen në zonë me qëllim eliminimin e incidenteve të mundshme.



Përfaqësim dinjitoz i Forcave Speciale të Regjimentit të Operacioneve Speciale, në stërvitjen “Balkan Shield”, në Greqi



“Veprimet e togës në mbrojtje”, ishte tema e mësimit tregues të zhvilluar nga efektivet e kompanisë III të batalionit të Tretë të Këmbësores, në kuadër të përgatitjes taktike që zhvillohet në këtë repart. Përvetësimi i temave taktike të ushtarit, skuadrës togës dhe kompanisë, janë baza themelore për të pasur ushtarë dhe komandantë të aftë për të kryer me sukses misionin e tyre luftarak në çdo kohë e situatë.



Atasheu ushtarak i Kosovës, vizitë në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë

Zëvendëskomandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel Emëror Hajdarasi, priti në takim atasheun ushtarak kosovar, nënkolonel Enver Hoti, (Atashe i Mbrojtjes në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Shqipëri).

Kolonel Hajdarasi, pasi i uroi mirëseardhjen, e njohu nënkolonel Hotin me Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, si strukturë e re e FARSH, misionin, detyrat, kurset që drejtohen dhe zhvillohen si dhe angazhimet në të ardhmen.

Nga ana e tij, atasheu ushtarak kosovar, nënkolonel Hoti shprehu mirënjohjen për mbështetjen dhe bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe kualifikimit mes dy vendeve, duke u shprehur se arsimimi përmban një themel të padiskutueshëm në sferën e Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Në përfundim të takimit atasheu ushtarak i Kosovës, nënkolonel Hoti zhvilloi një vizitë në Kursin Themelor të Oficerit të Shtabit (KTHOSH), Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP) dhe në Kursin e Lartë të Oficerit (KLO).



Në batalionin e Parë të Këmbësores, vijon me intensitet përgatitja e rekrutëve të rinj, nëpërmjet kursit të Stërvitjes Individuale Bazë (SIB)



Forca Detare, pjesë e stërvitjes "Neptune Strike 22"



Anijet e Forcës Detare, "Butrinti" dhe "Lisus", morën pjesë në stërvitjen "Neptune Strike 22", e cila u zhvillua në detin Adriatik dhe Jon.

Ekuipezhet tona, të sprovuar tashmë në operacione detare ndërkombëtare, demonstuan nivel të lartë përgatitjeje në stërvitjen e udhëhequr nga aeroplanmbajtësja amerikane "USS George H. W. Bush", që kishte për qëllim ndërveprueshmërinë mes aleatëve.



Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Armatimi i ushqimit dhe energjisë nga Rusia si pjesë e luftës së saj të paligjshme në Ukrainë nënvizon nevojën për të rritur elasticitetin, për të diversifikuar furnizimet dhe burimet e energjisë dhe për të përshpejtuar tranzicionin drejt ekonomive më të pastra dhe më të gjelbra, tha më 8 nëntor 2022, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg. Sekretari i Përgjithshëm hapi Diskutimin e Nivelit të Lartë mbi Sigurinë Klimatike, organizuar nga Konferenca e Sigurisë së Mynihut (MSC) në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (COP27) në Sharm El-Sheikh, Egjipt. Stoltenberg foli, virtualisht, në ngjarjen e bashkë-organizuar nga NATO, Zyra e Jashtme Federale Gjermane dhe Konferenca e Sigurisë në Mynih në COP27, Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike në Sharm El-Sheikh, Egjipt. Koncepti i ri Strategjik i NATO-s i miratuar në Samitin e Madridit më qershor përshkruan ndryshimin e klimës si një “sfidë përcaktuese e kohës sonë” dhe zotohet ta bëjë NATO-n “organizatën ndërkombëtare udhëheqëse”, kur bëhet fjalë për të kuptuar dhe përshtatur ndikimin e sigurisë së ndryshimeve klimatike. Ndërkohë në Madrid, NATO ra dakord gjithashtu për një objektiv konkret për të ulur emetimet nga strukturat dhe komandat e Aleancës me të paktën 45% deri në vitin 2030 dhe për të lëvizur drejt ‘Neto Zero’ deri në vitin 2050.

Ndryshimi i klimës krijon konflikt
Diskutim i nivelit të lartë mbi sigurinë e klimës me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s Jens Stoltenberg në Konferencën e këtij viti të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (COP27), u përqendrua kryesisht mbi pyetjet e drejtura nga Ambasadori Christoph Heusgen, Kryetar i Konferencës së Sigurisë së Mynihut. Në Konceptin e ri Strategjik të saj, NATO është angazhuar se “do të jetë organizata udhëheqëse ndërkombëtare kur bëhet fjalë për të kuptuar dhe përshtatur ndikimin e ndryshimeve klimatike në siguri” dhe lidhur me këtë angazhim Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg tha se Aleanca e bëri ndryshimin e klimës një çështje për herë të parë për NATO-n në në Samitin e NATO-s në qershor të këtij viti. “Duhet të kuptojmë se në konceptin strategjik që u lamë, derisa e përditësuam apo bëmë një të ri në qershor, nuk përmendet ndryshimi i klimës. Më pas, ne kuptuam gjatë dy viteve të fundit, se ndryshimi i klimës, është diçka që NATO duhet ta trajtojë. Ka 3 gjëra që NATO duhet të bëjë, të kuptojë plotësisht lidhjen midis ndryshimit të klimës dhe sigurisë; Ndryshimet klimatike ndikojnë sigurinë; Ndryshimi i klimës është një shumëfishues i krizës. Ajo rrit konkurrencën mbi burimet e pakta, ujin, ushqimin, tokën dhe ajo detyron miliona njerëz të ikin. Së pari, ndryshimi i klimës krijon konflikt. Ajo përkeqëson konfliktet dhe meqenëse ndryshimi i klimës ka rëndësi për sigurinë, ndryshimi i klimës ka rëndësi për NATO-n. Ne duhet ta kuptojmë plotësisht këtë lidhje sepse duhet të kuptojmë kërcënimet e ndryshme me të cilat përballemi. Pra, ne po ndërtojmë kapacitetet tona kur bëhet fjalë për të analizuar, kuptuar dhe vlerësuar lidhjen midis konfliktit të ndryshimit klimatik dhe sigurisë. E dyta që ka rëndësi për NATO-n është se, ndryshimet klimatike, moti më ekstrem, moti më erë, më i egër dhe më i lagësht ka rëndësi për operacionet ushtarake. Ne kemi një mision stërvitor në Irak dhe ata kanë përjetuar më shumë se 50 gradë Celsius. Pajisjet tona, uniformat tona, si të përshtatemi me motin më ekstrem, kemi shkrirenj e akullit në Arktik, ka rëndësi për rëndësinë strategjike të Arktikut. Rritja e nivelit të detit ka rëndësi në të gjitha bazat detare. Kështu që ne thjesht duhej t’i përshtatim operacionet ose misionet tona, pajisjet tona, uniformat tona me ndryshimet klimatike, me motin më ekstrem. Ne jemi në proces për ta bërë këtë duke përfshirë ndryshimet klimatike në planifikimin tonë ushtarak, objektivat tona të aftësisë dhe gjithçka që bëjmë. Së treti, forcat tona të armatosura duhet të



jenë pjesë e përpjekjeve për të reduktuar emetimet. Nëse shikoni atë që është si një pajisje ushtarake tradicionale, tanke të rënda beteje, luftanije, aeroplanë, ato zakonisht nuk janë shumë të gjelbra. Ata lëshojnë shumë emetime. Pra, ne duhet të gjejmë një mënyrë për të reduktuar emetimet ushtarake. Unë mora pjesë në COP-in tim të parë në 1997 në Kioto dhe atje më kujtohet se emetimi ushtarak ishte i përjashtuar në mënyrë eksplicite nga raportimi për emetimet nga vende të ndryshme. Pra, ata u përjashtuan nga i gjithë ekuacioni. NATO ka nisur një projekt për të standardizuar mënyrën se si raporton për emetimet nga operacionet ushtarake sepse ky është hapi i parë drejt reduktimit të emetimeve duke besuar se në të ardhmen, ne kemi nevojë për aftësi të gjelbra, por natyrisht edhe efektive ushtarake, por në të ardhmen, aftësitë ushtarake më efektive do të jenë ato të gjelbra dhe miqësore me mjedisin. Tre gjërat që NATO duhet të bëjë dhe po bën janë: të kuptojmë lidhjen midis ndryshimit të klimës dhe sigurisë; përshtatjes të misioneve dhe operacioneve ushtarake ndaj motit më ekstrem; dhe, zvogëlimi i emetimeve ushtarake, duke filluar me hartimin e emetimeve ushtarake në një mënyrë shumë më të mirë se sa sot”.

Implikimet globale të luftës së Rusisë kundër Ukrainës, siguria e ushqimit dhe energjisë

NAT, nga viti 1997 e deri më sot, ka qenë e integruar në përpjekjet për të parë se si mund të reduktojnë ndryshimet klimatike. Mirëpo situata e luftës së Rusisë në Ukrainë, agresioni i saj kundër Ukrainës, ka sjellë implikimet globale veçanërisht për sigurinë e ushqimit dhe energjisë, që lidhet gjithashtu edhe me ndryshimet klimatike. “Lufta në Ukrainë është një luftë brutale agresioni e nisur nga Presidenti Putin kundër kombit të pavarur sovran demokratik”, - tha Sekretari i Përgjithshëm. “Është një shkelje flagrante e integritetit territorial dhe sovranitetit të Ukrainës. Shkakton gjakderdhje, vuajtje, vdekje, vrasje të civilëve çdo ditë në Ukrainë. Prandaj, lufta duhet të përfundojë, sepse ajo shkakton kaq shumë vuajtje për ukrainasit”, - tha ai. Por, në krye të kësaj, lufta në Ukrainë ka pasojë globale. Ajo ka shkakuar krizë globale ushqimore, rritje të çmimeve të ushqimeve dhe krizë globale të energjisë. “Sepse ne duhet të kuptojmë se nuk janë sanksionet e vendosura nga BE, nga aleatët e NATO-s, nga SHBA-të, ato që kanë shkakuar një rritje të çmimeve të energjisë. Për më tepër, është fakti se për shkak se nuk ka sanksione kundër ushqimit, nuk ka sanksione kundër eksportit të grurit nga Ukraina. Pra, ajo që ka shkakuar këtë krizë ushqimore dhe energjetike është vetë lufta dhe kjo është një luftë e qëllimshme e Presidentit Putin. Ai ka armatosur qëllimisht ushqimin e energjisë në këtë përpjekje për të shtypur, për të marrë kontrollin mbi Ukrainën. Ka shkakuar

shumë dëme për njerëzit më vulnerabël në botë, sepse ata duhet të paguajnë një çmim të lartë për energjinë dhe çmim të lartë për ushqimin sesa para luftës. Jam i lumtur, jam i kënaqur që kemi Kombet e Bashkuara, Turqinë, një aleat të NATO-s dhe një komunitet ndërkombëtar që ka qenë në gjendje të negociojë, të bien dakord për marrëveshjen e grurit që ka mundësuar eksportin e grurit nga Ukraina që të paktën zvogëlojnë presionin në tregun global të ushqimit. Sapo vizitova Stambollin këtë fundjavë. Në fakt pashe anijet kryesore që lundronin nëpër ngushticën e Bosforit. Unë fola me presidentin Erdogan dhe, natyrisht, e vlerësova edhe për përpjekjet e Turqisë për të lehtësuar marrëveshjen e grurit. NATO vazhdon t’i bëjë thirrje Rusisë që të respektojë marrëveshjen e grurit dhe gjithashtu të jetë e gatshme të zgjasë marrëveshjen e grurit, sepse lufta është katastrofike që populli i Ukrainës të vuajë çdo ditë. Por lufta në Ukrainë ka edhe pasojë globale të shkaktoara jo nga sanksionet, por nga lufta. Mënyra më e mirë për ta trajtuar këtë është që Presidenti Putin t’i japë fund luftës, të ndalojë luftimet dhe të respektojë Ukrainën. Më pas do të shohim më shumë eksporte ushqimore, do të shohim më shumë eksporte energjie dhe kjo do të ishte mënyra më e mirë për të lehtësuar ose trajtuar pasojat e luftës”.

Zgjatja e luftës në Ukrainë, armëpushimi, negociatat dhe “presioni mbi të dyja palët” për të ndaluar luftën

“Luftërat janë nga natyra të paparashikueshme, por aleatët e NATO-s, partnerë në mbarë botën, duhet të vazhdojnë t’i ofrojnë mbështetje Ukrainës. Sepse nëse Rusia fiton në Ukrainë, kjo do t’i dërgojë mesazhin Presidentit Putin, por edhe liderëve të tjerë autoritarë, se ata mund të arrijnë rrugën e tyre, se mund t’i arrijnë qëllimet e tyre duke përdorur forcën brutale ushtarake. Si shumica e luftërave, tha shefi i NATO-s, kjo luftë, në një fazë, mund të përfundojë në tryezën e bisedimeve. Por ju e dini se ajo që ndodh rreth tryezës së bisedimeve lidhet thelbësisht me situatën në fushën e betejës dhe e vetmja mënyrë që Ukraina të arrijë një rezultat rreth atyre negociatave, që ka shumë të ngjarë të ndodhë në një fazë, e cila është e pranueshme për ta, dhe që siguron që Ukraina të mund të mbizotërojë si një komb sovran i pavarur, është që ata të kenë forcën në fushëbetje që mundëson një rezultat të pranueshëm në tryezën e bisedimeve. Mbështetja për Ukrainën, është për të forcuar dorën e saj. Kjo është një luftë agresioni ku një vend, Rusia, sulmon një vend tjetër, ku nëse Presidenti Putin dhe Rusia ndalojnë luftën, atëherë do të kemi paqe dhe nëse Presidenti Zelensky dhe Ukraina ndalojnë luftën, atëherë Ukraina do të pushojë së ekzistuari si një komb i pavarur. Mbështetja për Ukrainën dhe të drejtën për vetëmbrojtje, të drejtën e sanksionuar në Kartën e OKB-së, do të jetë mirë për

sigurinë tonë dhe për çmimet globale të ushqimit dhe energjisë dhe kjo e bën edhe më të rëndësishme për të ndalimin e luftës”. Shefi i NATO-s shpjegoi se çfarë do të thotë për Ukrainën, zgjatja e luftës, armëpushimi, negociatat apo presioni mbi të dyja palët për të ndaluar luftën. “Nëse ukrainasit dorëzohen ndaj kërkesave ruse dhe pranojnë që Rusia thjesht mund të hyjë, të pushtojë atë pjesë të Ukrainës dhe më pas ta shkëpusë atë, atëherë ekziston rreziku që kjo jo vetëm t’i inkurajojë ata të sulmojnë dhe pastaj ata të arrijnë gjithnjë e më shumë pas çdo pushtimi”, - tha Sekretari i Përgjithshëm. “Duhet të kujtojmë se kjo luftë nuk filloi në shkurt 2022, ajo filloi në 2014, kur Rusia aneksoi ilegalisht Krimenë dhe mori kontrollin mbi pjesën lindore të Ukrainës, dhe tani ata sulmuan përsëri dhe filluan një pushtim të plotë në shkurt. Nëse ukrainasit dorëzohen ndaj kërkesave ruse për Ukrainën, kjo është gjithashtu e rrezikshme sepse dërgon mesazhin se përdorimi i forcës brutale është mënyra për të arritur qëllimet politike, për të marrë kontrollin mbi një vend fqinj. Duhet të kujtojmë gjithashtu se në fillim të luftës, Rusia deklaroi ambicie jo vetëm për Ukrainën, por edhe për aleatët e NATO-s. Ata donin të parandalonin Finlandën dhe Suedinë që të bëheshin anëtarë të NATO-s, siç do të ftoheshin në të vërtetë dhe që NATO të largonte të gjitha forcat e saj nga pjesa lindore e Aleancës, për të futur një lloj anëtarësimi të klasit të dytë në këtë Aleancë. Problemi kryesor është se Rusia dëshiron të krijojë një sistem, një sferë ndikimi, ku ata mund të vendosin se çfarë mund të bëjnë ose jo fqinjët, dhe kjo është një botë më e rrezikshme. Kjo është arsyeja pse ajo është e përfshirë në Kartën e OKB-së dhe çdo vend ka të drejtën e vetëmbrojtjes dhe Ukraina po mbrohet. NATO, aleatët e NATO-s nuk janë pjesë e konfliktit, por ne mbështesim Ukrainën në ruajtjen e të drejtës së OKB-së për vetëmbrojtje. Nga ana tjetër të gjithë duan që kjo luftë të përfundojë, por nëse Ukraina e ndalon luftën, ajo do të pushojë së ekzistuari si një komb i pavarur, nëse Rusia naulet, ne do të kemi paqe. Më pas, pasojat globale, ato parashtrihen nga fakti se Rusia bllokoi portet e Ukrainës, për shumë muaj. Ata vodhën grurë, vodhën anije dhe e kanë vështirësuar shumë eksportin e mallrave kritike. Kjo ka shkakuar pasojë për çmimet e ushqimeve dhe energjisë, faktorë me ndikim global. Ne duhet t’i japim fund luftës dhe mënyra më e mirë dhe më e lehtë për ta bërë këtë është që Presidenti Putin të respektojë sovranitetin mbi një fqinj, Ukrainën”. Sekretari i Përgjithshëm tha se ajo që kemi parë në luftën e Ukrainës dhe Rusisë, ose përdorimi i energjisë si armë kundër aleatëve të NATO-s dhe vendeve të tjera, “është një kujtesë e ashpër e nevojës për të kaluar nga varësia nga karburantet fosile ndaj burimeve të rinovueshme sepse kjo do të na bëjë më pak të varur nga gasi rus dhe nafta ruse”, - tha ai, dhe kjo është arsyeja që të kalohet nga lëndët djegëse fosile në burimet e rinovueshme, për sigurinë dhe për klimën.

Objektivat e NATO-s për klimën dhe shpenzimet e mbrojtjes

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg tha se e kuptonte plotësisht se është e vështirë për aleatët e NATO-s të përmbushin udhëzimet e NATO-s për të shpenzuar më shumë për mbrojtjen, 2% të PBB-së, në situatën aktuale. Të gjithë aleatët e NATO-s, reduktuan shpenzimet e mbrojtjes pas Luftës së Ftohtë, sepse tensionet ranë. “Ne jetuam në një botë më paqësore dhe më të sigurt pas Luftës së Ftohtë, por realiteti brutal është se ne jetojmë tani në një botë më të rrezikshme. Ne jetojmë tani në një botë ku shohim veçanërisht Rusinë duke përdorur forcën

ushtarake kundër fqinjëve të saj. E kemi parë në Gjeorgji në vitin 2008. Ata kanë forca në Moldavi pa pëlqimin e qeverisë në Moldavi. Më pas ata përdorën forcën ushtarake kundër Ukrainës në 2014 dhe tani përsëri, pushtim i plotë në këtë dimër. Pra, e gjithë kjo, për fat të keq, e ka bërë botën më të rrezikshme. Reduktimi i shpenzimeve të mbrojtjes mund të bëhet kur tensionet janë në rënie dhe të rriten shpenzimet e mbrojtjes kur tensionet rriten. Më vjen keq për këtë sepse e kuptoj plotësisht se ka shumë qëllime apo qëllime të tjera për të cilat politikanët pëlqejnë të shpenzojnë para si ndryshimi i klimës, mbështetja për vendet në zhvillim, arsimi dhe shumë qëllime të tjera. Por, nëse nuk kemi paqe, nëse nuk kemi siguri, atëherë do të dëshitojmë me të gjitha detyrat e tjera që na presin. Pra, një parakusht për të qenë në gjendje të trajtojmë ndryshimet klimatike është që të ruajmë paqen. Dhe kjo është arsyeja pse ne gjithashtu duhet të investojmë”, - tha ai dhe theksoi, se e vetmja mënyrë për të mbështetur Ukrainën është t’i ofrojmë atyre mbështetje ushtarake. “Prandaj, me keqardhje them se ka nevojë për të investuar më shumë në mbrojtje. Përsëri, nëse do të shihnim një Rusi më pak agresive, atëherë nevojat nuk do të kishte qenë aq e madhe për të investuar aq shumë në mbrojtje sa duhet të bëjmë tani. Pa paqe, ne nuk do të jemi në gjendje të trajtojmë çështjet e zhvillimit ose çështjet e ndryshimeve klimatike. Objektivi i NATO-s është të shkurtojë emetimet nga organet dhe komandat e NATO-s me të paktën 45% deri në vitin 2030 dhe drejt ‘zero neto’ deri në vitin 2050. Ne duhet ta bëjmë këtë në mënyra të ndryshme. Nuk mendoj se NATO mund të mbetet një lloj Aleance e karburanteve fosile në një botë të burimeve të rinovueshme. Kur sheh sektorin civil që zhvillon gjithnjë e më shumë motorë modernë, makina elektrike, automjetë elektrike, të cilat janë të gjelbra dhe efektive”. Stoltenberg tha se në të ardhmen nuk do të ketë kontradiktat midis gjelbërimit dhe efektivitetit, aftësitë ushtarake më efektive do të jenë gjithashtu të gjelbra. “NATO duhet të jetë pjesë e atij revolucionit teknologjik”, tha ai.

Siguria njerëzore, si pjesë ose e lidhur me sigurinë klimatike

Është pjesë e strategjisë kur përpikemi të adresojmë ndryshimin e klimës në të gjitha operacionet dhe misionet ushtarake. Ndryshimi i klimës ndikon në sigurinë njerëzore çdo ditë, siç e shohim me thatësitë, me përmbajtjet, pasojat ekstreme që shkaktohen nga ndryshimet klimatike. “Edhe ata që nuk marrin pjesë në konferencë si unë, sigurisht që lexojnë raporte dhe shohin se kjo është tema kryesore e konferencës”, - tha Sekretari i Përgjithshëm. “Kjo është arsyeja tjetër pse mendoj se takimi në Sharm El Sheikh është kaq i rëndësishëm. Për NATO-n, ekziston lidhja midis ndryshimit të klimës dhe sigurisë, ndryshimi i klimës është një shumëfishues i krizës, efektet në çështjet e sigurisë për NATO-n. Siguria njerëzore cenohet çdo ditë. Moti është më i ngrohtë se kurrë. Ne shohim tani në Europë se siguria njerëzore dhunohet çdo ditë në Ukrainë. Mënyra më e mirë për ta parandaluar këtë është ruajtja e paqes dhe detyra kryesore dhe kryesore e NATO-s është parandalimi i luftës, ruajtja e paqes. NATO nuk provokon konflikt, por në fakt parandalon konfliktin, ajo e bën këtë duke qëndruar së bashku, duke mbrojtur njëri-tjetrin dhe për më shumë se 70 vjet ka ruajtur paqen në Europë për aleatët e saj. Ukraina nuk është aleati i NATO-s, por Ukraina është një partner i ngushtë, dhe për këtë arsye ne mbështesim Ukrainën për të ndaluar një gjakderdhje të pakuptimtë vuajtjeje që shkaktohet nga lufta e agresionit nga Presidenti Putin”.



LITUANI, 11-12 KORRIK 2023

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s shpall datat e Samitit të Vilniusit 2023

“Kam kënaqësinë të njoftoj se takimi i radhës i krerëve të shteteve dhe qeverive të NATO-s do të zhvillohet në Vilnius, më 11-12 korrik 2023”, - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, më 9 nëntor 2022, duke shpallur datat e Samitit të radhës të krerëve të shteteve dhe qeverive të NATO-s, i cili do të mbahet në Vilnius, 2023. “Ne përballemi me mjedisin më kompleks dhe të



paparashikueshëm të sigurisë që nga Lufta e Ftohtë. Takimi në Vilnius do të jetë një mundësi për krerët e shteteve dhe qeverive aleate që të bien dakord për hapat e mëtejshëm për të forcuar parandalimin dhe mbrojtjen tonë dhe të rishikojnë rritje të konsiderueshme në shpenzimet e mbrojtjes, si dhe të vazhdojnë mbështetjen tonë për Ukrainën. Në një epokë të konkurrencës strategjike në rritje, lidhja transatlantike midis Europës dhe Amerikës së Veriut

në NATO vazhdon të jetë thelbësore për sigurinë e një miliard qytetarëve tanë. I jam mirënjohës Lituanisë për pritjen e Samitit tonë. Lituania është një aleat jetik i NATO-s. Si mikpritëse e një grupi betejesh shumëkombëshe, Lituania ndihmon për të siguruar parandalim dhe mbrojtje të fortë për të gjithë Aleancën. Mezi pres një Samit të suksesshëm në Vilnius në korrik 2023”, - njofton Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s.

NË NJË BOTË TË RREZIKSHME, ËSHTË EDHE MË E RËNDËSISHME TË QËNDROJNË SË BASHKU NË NATO

Mbretëria e Bashkuar, rol kyç në NATO

Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg vlerëson MB për mbështetjen ndaj Ukrainës

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, më 09 nëntor 2022, falënderoi kryeministrin Rishi Sunak për kontributet kryesore të Mbretërisë së Bashkuar në NATO dhe mbështetjen e saj të fortë për Ukrainën.

Duke folur jashtë “10 Downing Street”, pas bisedimeve me Kryeministrin, Stoltenberg vlerësoi Mbretërinë e Bashkuar për udhëheqjen e grupit të betejës shumëkombëshe të NATO-s në Estoni dhe për ofrimin e avionëve dhe anijeve për patrullat e NATO-s. Ai gjithashtu përshëndeti mbështetjen e fortë të Mbretërisë së Bashkuar për Ukrainën, duke përfshirë ofrimin e trajnimit për rreth 30 000 ushtarë ukrainas gjatë viteve të fundit.

Sekretari i Përgjithshëm theksoi rëndësinë e vazhdimin të mbështetjes së Ukrainës. “Nëse presidenti Putin fiton në Ukrainë, do të ishte katastrofike për ukrainasit, por do të na bënte edhe më të pambrojtur, sepse mesazhi për presidentin Putin dhe për liderët e tjerë autoritarë do të ishte se ata mund të largohen për të arritur qëllimet e tyre, duke përdorur forcën brutale ushtarake”.

I pyetur në lidhje me raportet për një tërheqje ushtarake ruse nga Kherson, Sekretari i Përgjithshëm tha: “Ne e kemi parë njoftimin, por do të presim dhe të shohim se çfarë ndodh në të vërtetë në terren”. Ai shtoi: “Është inkurajuese të shohësh se si forcat e guximshme ukrainase janë në gjendje të çlirojnë më shumë territor ukrainas. Fitoret, fitimet që po bëjnë u përkasin ushtarëve të guximshëm ukrainas, por mbështetja që ata marrin nga Mbretëria e Bashkuar dhe nga aleatët e NATO-s është gjithashtu thelbësore”.

Gjatë vizitës më herët, Stoltenberg zhvilloi bisedime me Sekretarin e Jashtëm James Cleverly, në Londër. Sekretari i Përgjithshëm iu bashkua gjithashtu Sekretarit Britanik të Mbrojtjes, Ben Wallace, në kampin e ushtrisë “Lydd”, ku trupat ukrainase po trajnohen nga forcat britanike, kanadeze dhe lituaneze. Sekretari i Përgjithshëm u takua gjithashtu me trupat ukrainase dhe i lavdëroi ata për angazhimin dhe guximin e tyre ndërsa vazhdojnë të kundërshtojnë luftën brutale dhe të paprovoquar të agresionit të Rusisë.

MB ka qenë dhe është një komb kryesor për ofrimin e mbështetjes për Ukrainën

“Faleminderit për mbështetjen tuaj të fortë për NATO-n, për aleancën tonë transatlantike, në këtë botë më të rrezikshme, është edhe më e rëndësishme që ne të kemi një lidhje



të fortë midis Amerikës së Veriut dhe Europës, siç kemi në NATO”, - tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, në deklaratën e tij me Kryeministrin e Mbretërisë së Bashkuar Rishi Sunak. “Është e mrekullueshme të jem këtu së bashku me ju dhe të jem i ftuar t’ju vizitoj dhe

të kthehem në “10 Downing Street”, - tha ai. “Mbretëria e Bashkuar kontribuon në mbrojtjen aleate kolektive në mënyra të ndryshme. Ju drejtoni grupin e betejës shumëkombëshe në Estoni, ju mbani të sigurt qiejt mbi krahun tonë lindor me policimin ajror të Mbretërisë së Bashkuar dhe pastaj

ju gjithashtu kontribuoni me shumë anije, aftësi detare në misionet dhe patrullimet tona detare”, - tha Stoltenberg. “Mbretëria e Bashkuar ka qenë dhe është një komb kryesor kur bëhet fjalë për ofrimin e mbështetjes për Ukrainën, ju keni trajnuar ushtarët ukrainas për shumë vite. Por tani padyshim që ju u rritët pas pushtimit dhe siç e përmendët, ky objekt trajnimi në MB, ku takova ushtarë të guximshëm ukrainas të trajnuar nga trajnerë të Mbretërisë së Bashkuar, por edhe trajnerë nga vende të tjera aleate të NATO-s. Kjo tregon rolin udhëheqës që keni në aleancë dhe jam absolutisht i sigurt se mund të vazhdoj të mbështetem në Mbretërinë e Bashkuar në një botë më të kontestuar dhe se ne të gjithë duhet të investojmë më shumë në mbrojtjen tonë kolektive dhe në një botë ku ne jemi më të sfiduar nga regjimet autoritare”, - tha ai në deklaratën e tij. Në konferencën për shtyp Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, informoi se kishte përfunduar një takim shumë të mirë dhe produktiv me kryeministrin Rishi Sunak dhe se e kishte vlerësuar atë dhe Mbretërinë e Bashkuar për mbështetjen e fortë ndaj Aleancës transatlantike, ndaj NATO-s, dhe Mbretëria e Bashkuar është një aleat kyç dhe udhëheqës në shumë mënyra të ndryshme. Mbretëria e Bashkuar udhëheq grupin luftarak shumëkombësh të Aleancës në Estoni. “Mbretëria e Bashkuar mban të sigurt

qiejt mbi krahun tonë lindor duke qenë pjesë e policisë sonë ajrore në pjesën lindore të Aleancës. Anijet detare britanike janë një pjesë e rëndësishme e patrullimeve të NATO-s rreth territorit të NATO-s”, - tha ai.

“Unë gjithashtu vlerësova Kryeministrin për mbështetjen e fortë që Mbretëria e Bashkuar i jep Ukrainës. Sot në mëngjes vizitova një nga vendet e stërvitjes për ushtarët ukrainas. Pashë, këtu në Mbretërinë e Bashkuar, dhe pashë ushtarët e rinj ukrainas duke u trajnuar nga trajnerë britanikë, por edhe trajnerë nga Kanada, Lituania, nga vende të tjera aleate të NATO-s, duke dëshmuar se si Mbretëria e Bashkuar luan një rol kyç në udhëheqjen tonë, në përpjekjet për të ofruar mbështetje për Ukrainën”.

Mbretëria e Bashkuar e ka bërë këtë për shumë vite dhe ka trajnuar afër 30 000 ushtarë ukrainas, janë rritur pas pushtimit dhe mesazhi është se ne duhet të vazhdojmë të mbështesim Ukrainën. Nëse presidenti Putin fiton në Ukrainë, do të jetë katastrofike për ukrainasit, por gjithashtu na bën më të pambrojtur, sepse atëherë mesazhi për Presidentin Putin, për liderët e tjerë autoritarë, do të jetë se, ata mund të arrijnë rrugën e tyre, të arrijnë qëllimet e tyre duke përdorur forcën brutale ushtarake. Prandaj ky ishte një takim i mirë dhe kam besim se po vazhdoj të llogaris Mbretërinë e Bashkuar si një aleat kryesor i NATO-s.”

Stoltenberg: Kosova dhe Serbia të përmbahen nga veprimet që përshkallëzojnë tensionet

Situata e tensionuar në veri të Kosovës

Stoltenberg: Kosova dhe Serbia të përmbahen nga veprimet që përshkallëzojnë tensionet

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë të shmangin veprimet që mund të përshkallëzojnë situatën pas zhvillimeve të fundit në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe.

Sekretari Stoltenberg shkroi në rrjetet sociale se ka biseduar me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin e Serbisë, Aleksander Vuçiq për situatën e tensionuar në veri të Kosovës.

“U kërkova të dyve që të përmbahen nga çdo veprim i njëanshëm që mund të nxisë përshkallëzim. Dialogu është e vetmja rrugë përpara”, - shkroi ai duke theksuar se forcat e KFOR-it mbeten syçelë përballë situatës.

Edhe zëvendëssekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mircea Geoana, ka reaguar pas situatës së krijuar në veri të Kosovës: “Si Beogradi ashtu edhe Prishtina duhet të tregojnë përmbajtje dhe të parandalojnë përshkallëzimin”.

Zëvendëssekretari i Përgjithshëm, Geoana, përmes një reagimi në Twitter ka njoftuar se ka biseduar me emisarin special të BE-së për dialogun, Kosovë-Serbi, Miroslav Lajčak. Ai tha se Kosova dhe Serbia duhet të



parandalojnë përshkallëzimin, duke shtuar se KFOR-i është i gatshëm për të ndërhyrë nëse rrezikohet stabiliteti. “Fola me Përfaqësuesin Special të BE-së, Miroslav Lajčak për situatën e tensionuar në veri të Kosovës. Si Beogradi ashtu edhe Prishtina duhet të tregojnë përmbajtje dhe të parandalojnë përshkallëzimin. NATO - KFOR mbetet vigjilent dhe i gatshëm për të ndërhyrë nëse rrezikohet stabiliteti”, - shkruan ai.

Por nga ana tjetër Forcat paqeruajtëse në Kosovë dhe komandanti i KFOR-it janë në kontakt të ngushtë me të gjitha autoritetet dhe se kjo forcë mbetet vigjilente dhe nuk ka asnjë ndryshim në paraqitjen e forcës së saj. Trupat e KFOR-it po vëzhgojnë situatën në terren dhe vazhdojnë të zbatojnë mandatin e tyre në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të vitit 1999, për të garantuar një mjedis të sigurt dhe lirinë e lëvizjes për të gjithë qytetarët e Kosovës. Është thelbësore që të gjitha palët të vazhdojnë dialogun për hir të sigurisë në Kosovë dhe qëndrueshmërisë në rajon”, - thuhet në përgjigjen e KFOR-it.

PROF. ASOC. DR. KOLONEL (R)
ZAHO GOLEMI
MSC KOLONEL (R) BILBIL DERVISHI

Rustem Kabashi ishte dhe mbeti një legjendë e gjallë e shqiptarisë, burrë me vlera të rralla atdhetare, bir i shquar i fshatit Kabash këtej dhe përtej kufirit administrativ shqiptaro - shqiptar. Ndërkohë që ditët e fundit në kuadrin e 110 - vjetorit të krijimit të shtetit shqiptar ka dalë në dritë një vepër e rëndësishme historiografike për Rustem (Rrustë) Kabashi, për këtë dëshmor dhe hero të pashpallur, për këtë luftëtar e prijës dinjitoz të historisë së kombit shqiptar. “Rustem Kabashi - Haxhi Rustë Kabashi (1835-1910)” (në dokumente, në folklor e në historiografi), është një memorial kujtese, për trimin e madh të etiketuar edhe si “Robin Hudi shqiptar”. Jeta dhe vepra e Rustem Kabashit është një copëz e historisë shqiptare, për një vlerë të spikatur të atdhetarisë dhe trimërisë shqiptare, që edhe pse e varën në litar pushtuesit osmanë më 18.08.1910, nuk ia shuan as zërin as famën, nuk ia shuan dot diellin patriotik që e ndriçon në të gjitha epokat e kombit. Varja në litar e këtij trimi e bëri edhe më të famshëm dhe më frymëzues për djalërinë kryengritëse shqiptare. Libri për Rrustën është një ringjallje të shpirtit atdhetar, në kuadër të 110-vjetorit të krijimit të shtetit shqiptar është homazh, nderim e respekt për Rustem Kabashin, Rrustën e historisë shqiptare.

Rustem Kabashi lindi e u rrit në një truall atdhetar, më 15.05.1835. Ai ishte biri i Rexhep agë Balës dhe i nënë Halimesë. Luftërat e shekullit të XIX, dhe veçanërisht LSHP, kryengritjet e viteve 1884-1885 dhe kryengritjet në prag të pavarësisë të 1909-1910, e bënë Rrustë Kabashin të njohur si luftëtar, si prijës, si organizator dhe bashkëluftëtar i prijësve si Sulejman Vokshi e dhjetëra burrave që i bënë nder shqiptarisë. Ai ishte një atdhetar e luftëtar i rrallë, që në rininë e tij të hershme dhe për të shprehja se, “Shqiptarin nuk e ka qitë lokja prej barku, por huta prej çarku”, është më se e përshtatshme. Jeta e Rrustë Kabashit është jeta e një heroi, që edhe me familjen e madhe që krijoi kishte 19 fëmijë, 14 djem dhe 5 vajza, në katër martesat e tij. Heroi i Kabashit dhe i mbarë kombit shqiptar ka qenë katër herë i burgosur, katër herë i internuar dhe për mosbindje ndaj pushtuesit osman. Ai provoi burgjet në Prizren, Shkup, Selanik, Stamboll, Jemen, Kastomani. Duke qenë se pushtuesi nuk ia doli dot me të, së fundi e vari në qendër të Prizrenit, sepse gjyqi ushtarak osman e dënon me varje në litar. Fjala e tij e fundit u bë frymëzim brezash atë mëngjes të 18 gushtit 1910, në shatërvanin e Prizrenit: “Ma mirë në litar se i posh-truem si tradhëtar!” Këto ishin fjalët e burrit 75 vjeçar që nuk kishte litar që t’ia mbyste fjalën. Kështu si osmanët do vepronin të gjithë pushtuesit dhe armiq të shqiptarisë. Me aktin sublim në moshë të madhe të Rrustë Kabashit tregohet qartë se pushtuesi e kishte frikë deri në palcë prej tij, sepse ai nuk ishte as aga, as bej, as feudal, por ishte një malësor e tribun popullor, që dëshironte që populli të jetonte i lirë. Bashkë me Rrustë Kabashin u varën 17 udhëheqës të kryengritjeve antiosmane. Libri i porsadalë është një homazh për Rustem Kabashin, që ndriçon një epokë errësirë nën pushtim. Libri vlerëson guximin, trimërinë, besnikërinë, bujarinë, për



burrrë kuvendi dhe fjalën e mençur, për komunikimin e spikatur, për pleqnar e pajtimtar gjaqesh, luftëtar i rreshtit të parë, por dhe prijës i djalërisë, njeri i panënshtuar si kabashas i paepur, si prijës për vetëqeverisje sipas traditave shekullore, pa diskriminime të shtresës nga niveli i pasurisë si dhe pa diskriminime fetare. Mbi të gjitha spikaste shekujve tradita shqiptare e bijve të Kabashit, që ka ardhur deri në ditët tona si oshtimë e shekujve: “Mikun prite me bukë, hasmin me pushkë!”

Të parët e Rustemit erdhën nga Kabashi, por me vete morën rrënjët, traditat dhe zakonet e fisit dhe mbiemrin e fshatit, pse jo, ribënë një Kabash të ri në Prizren, për të cilat i qartëson që në hyrje të librit Xhemal Meçi. Ky hulumtim dokumentar i bën nder librit dhe është një gjetje e duhur e autorit Profesor Shefqet Hoxha, që ia beson në mënyrë fisnike hyrjen një burri me dijeni të thella arkivistike, që ka qëmtuar thellë në historinë e Kabashit, e deri në Kolonjë, që është si një udhërrëfyes për brezat që kërkojnë të zbulojnë trashëgiminë njerëzore e luftarake të fisit dhe gjerë. Mbi të gjitha vendlindja është pika e dobët e çdo njeriu. Kujtimet e rinisë janë ato që të mbërthejnë, pse jo të gozhdojnë në një dashuri që s’ka të dytë si vendlindja. Ajo nuk mund të ndërrohet dhe as tjetërsohet prandaj shumë njerëz kur janë ngopur me të mirat e jetës, përsëri u mungon një copëz

vendlindje si Kabashi, Puka, treva malësore e bjeshkëve, që pavarësisht ashpërsisë e vështirësive, atje është rrënjësuar fort dashuria e njerëzve. Kështu dhe Rrusta i mësuar me qeverisjen vendore në Malet e Dukagjinit nuk duronte shtypjen e shfrytëzimin. Burrin e mençur të Kabashit nuk kishte pushtues që ta lidhte dhe ta bënte zap, as me burgosje dhe as me internime. Libri i profesor Hoxhës: “Rustem Kabashi - Haxhi Rrustë Kabashi (1835-1910)” (në dokumente, në folklor e në historiografi) na sjell një dimension mençurie, të Kabashëve, që ditën të hedhin rrënjë dhe ta bëjnë solid fshatin e tyre edhe përtej vijës administrative të kufirit shqiptaro-shqiptar të ndarë dhunshëm në vitin 1913 nga Fuqitë e Mëdha. Kështu Kabashin e Pukës e gjejmë edhe në Prizren si Kabashi i Prizrenit. Gjenerali shqiptar qëndron fuqishëm i lidhur si pjesë e vitalitetit shqiptar, si pjesë e atdhetarisë që bijtë e shqipes e kanë pa kursim kur fjala është për trashëgiminë arbërore shqiptare, e cila u vërtetua dhe në luftën e UÇK-së si pjesë e rëndësishme e luftërave këtej dhe matanë kufirit për identitetin kombëtar. Rustem Kabashi, përmes dokumenteve që sjell në libër profesor Shefqet Hoxha, është dukshëm një “Robin Hud shqiptar”, i pamposhtur, gjithmonë në lidhje e bashkëveprim me titanë të kombit shqiptar si Sulejman Vokshi, Ramadan Zaskoci, Ali Ibra, e shumë të tjerë. Në

libër gjenden dhe 50 stacionet jetësore të dokumentuara mjeshtërisht, me pohime historiografike nga Risto Siliqi, Nikollë Ivanaj, Shukri Rrahimi, Xhafer Kabashi, Skënder Luarasi, Destan Bajraktari, Zekeria Cana, Shaban Braha, Fatmire Musaj, Jusuf Bajraktari, Sabri Maxhuni Novosella etj. Historiografia e ka detyrim profesional për të sqaruar dimensionin madhështor të figurave kombëtare edhe kur pushtuesi ka dashur t’i kompleksojë ato. Burimet e trashëgimisë gojore kanë vendin e vet por depërtimi thellë në jetën dhe veprën e Rrustë Kabashit, në arkivin e Institutit të Historisë, në materiale të arkivave të Vjenës, në Raportet e konsujve në Prizren, në deponimet në gjyqet ushtarake në Prizren, në xhaminë dhe mejtepin që ndërtoi në fshatin e tij, në kontributin si pajtues të mbi 500 gjaqeve, në besnikërinë ndaj besimit, ku ka qenë dhe dy herë në Qabe më 1902 dhe 1907. Të gjitha bashkë flasin për të vërtetat që pluhuri i historisë nuk mund t’i mbulojë. Në historinë e trimërisë shqiptare padyshim që Rrustë Kabashi ka një vend nderi dhe në këngët folklorike. Në gjithë hapësirën shqiptare këngë u këndohet veçanërisht trimave e trimërive, lavdisë së bijve. Por Rrustës i është kënduar që për së gjalli. Në dhjetëra e qindra raste artistët e popullit kanë shkruar vargje sikurse është kënga, që poeti depërton në mendjen e Sulltanit: pesë vilajete, / I thonë Sulltanit: “jepe!”. / Nuk e jap e kam për vete. / E kam për kohë të keqe. / Se i thonë dyfekut “lepe!”...”. Ndërkohë që tribunit popullor Rrustë Kabashi, kënga ia kthen vlerat në vargje: “Çiftelia kangën ka nis, Prej Shqipnie në Korish, / Hej, Korisha e Prizrenit, / Nderi burrnia e vendit. / Nëpër kulla, ndejë për rrashit, kanga i këndohet Rrustë Kabashit, / Gjithë kabashët kudo që janë, Në Kosovë e n’Shqipninë nanë, / Kanë rrit trima për liri, / Nëpër shekuj plot lavdi. / Ndihet zani apet: / Sulejmani (Vokshi) hypi n’thep. / Porsi zana po pisket: / Ju Kabashë, bini he burra, / Qitni n’thika e kacaturra. / Kep mbi kep e gur mbi gur, / Gjithmonë dolën me flamur, Gjëmon fusha e ushton mali. / N’ball prin Rrustë Kabashi. / Rrusta ish baru ti pushkës, / Shpirti i tij ishte liria, Andrra e tij ish Pavarësia..”. Dy vjet pas varjes në litar të Rrustë Kabashit erdhi Pavarësia shqiptare, por do të duhej të vinte 1999 që të vinte edhe pavarësia e Dardanisë, që ishte edhe ëndrra e Rrustë Kabashit. Atë e prunë djemtë e çikat e UÇK-së në tokë dhe NATO në ajër. Por mbi të gjitha 40 pasardhës të Rustem Kabashit dhe intelektualët si Profesor Shefqet Hoxha, pas një shekulli i hoqën litarin dhe ia lëshuan zërin-kushtrim patriotit Rustem Kabashit, që grisën mjegullën mbi të vërtetën historike të njerit prej luftëtarëve më të spikatur të lirisë dhe pavarësisë shqiptare. Destinacioni i

këtyre librave për atdhetarinë është qartësisht i dukshëm. Intelektualizmi shqiptar gjithmonë do të ketë uri dhe dëshirë që të lexojë të vërtetat historike shqiptare për të gjitha periudhat e luftës për liri pavarësi dhe të drejtave të shqiptarëve. Libri “Rustem Kabashi - Haxhi Rustë Kabashi (1835-1910), (në dokumente, në folklor e në historiografi)”, do të zërë vend në kolanën e librave më të lexuar të çdo kohe për mendimin historik shqiptar e më gjerë. Këtu nuk kemi të bëjmë me një stoli bibliotekash, por vlerë e atdhetarisë shqiptare, që meriton vëmendje në rrethet e gjera intelektuale e shoqërore, por edhe për institucionet këtej e matanë kufirit shqiptaro-shqiptar. Historia e Rustem Kabashit është historia e një personazhi historik që të drithëron, që takon telat e zemrave atdhetare e patriotike. Rustem Kabashi është vlerësuar me urdhrin “Për veprimtari patriotike të klasit I”, nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë me dekret nr. 435, datë 26.01.1993, me motivacionin “Udhëheqës, propagandues e luftëtar për mbrojtjen e trojeve nga pushtuesit, duke qenë shembull për pasuesit e luftës për çlirim e pavarësi”. Patrioti i shquar Rustem Kabashi, meriton plotësisht të nderohet e respektohet në mënyrë të përvitshme, por edhe institucionet e shtetit, bazuar në Ligjin nr. 109/2018, datë 20.12.2018, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, neni 5, “Kriteret për shpalljen e statusit ‘Dëshmor i Atdheut’”; meriton akordimin e dhënies së statusit “Dëshmor i Atdheut”. Vetëm në këtë mënyrë do të nderohet vepra dhe gjaku i bijve më të mirë të kombit të rënë në beteja. Emri dhe vepra e Rustem Kabashit meriton të nderohet thellësisht si dëshmor i kombit shqiptar dhe vendin padyshim e ka në panteonin e burrave të ndritur të kombit shqiptar. Mirënjohje, homazh dhe përjetësi për burrin e shquar, patriot të Kabashit, Rustem Kabashin! Bibliografia për Rustem Kabashin: Shefqet Hoxha, Rustem Kabashi - Haxhi Rustë Kabashi (1835-1910)” (në dokumente, në folklor e në historiografi), Tiranë, 2022; Materiale të Arkivit të Institutit të Historisë pranë ASA-së, në Tiranë, Raportet që konsulli austro-hungarez Prohaskës dërgonte nga Prizreni për Ministrin e Jashtëm austro-hungarez në vitin 1910; Sabit Abdyl, “Kabashi i Anamoravës”, Prishtinë, 1997; “Ankthi i Pranverës ‘99”, Prishtinë, 2004; “Na, kabashi jem t’ ndam një zjarrmi”, Gjilan, 2013; “Tybe këta veç kabash janë”, Prishtinë, 2016; Noel Malcolm - “Histori e shkurtër e Kosovës”, Prishtinë, Tiranë, 2001; Xhemal Meçi, “Kabashi”, Tiranë, 2008; Zenun Rexhepi, “Kabashi i Moravës së Epërme, Prishtinë, 2003; Zenun Rexhepi, “Shkolla Filllore e Kabashit të Moravës 1948-1968, Prishtinë, 2008.

Arkeologjia Shqiptare, syri historik mijëravjeçar

Interesi për vlerat arkeologjike të Shqipërisë nis qysh në shek. XIX, kur studiues të gjeografisë historike iu kushtuan lokalizimit dhe identifikimit të të dhënave nga burimet antike. Kështu, është i pari që viziton Shqipërinë francezi Pouqueville, anglezi Martin Leake, nga shëtitja që bëri në Shqipërinë e Jugut deri në Apoloni, botoi një përshkrim të hollësishëm të rrënojave të objekteve arkeologjike që i ranë në sy. Më vonë arkeologu francez L. Heuzey vizitoi Shqipërinë dhe në studimin e tij u ndal kryesisht mbi Durrësin e Apoloninë.

Në fillim të shek. XX vizitoi Apoloninë dhe rrethinat e Vlorës ballkanologu C. Patsch. Ai është i pari që zbuloi qytetin e Amantias dhe më pas botoi një studim të hollësishëm mbi antikitetet që pa në Bylis, Klos, Berat etj. Gjatë Luftës së parë botërore erdhën në Shqipëri arkeologët austriakë C. Praschniker e A. Schober, të cilët filluan kërkimet nga veriu i Shqipërisë në drejtim të jugut dhe i kushtuan vëmendje edhe monumenteve e qendrave arkeologjike ilire.

Më 1924 një mision arkeologjik francez, nën drejtimin e Leon Rey, fillon gërmimet sistematike në Apoloni, të cilat vazhduan deri më 1938 dhe rezultatet u botuan në revistën “Albania”. Një mision tjetër arkeologjik italian, më 1926 filloi gërmimet në qytetin antik të Foinikes dhe më vonë në Butrint. Pas Luftës së Dytë Botërore deri më 1990 kërkimet e studimet arkeologjike u bënë nga arkeologë shqiptarë. Më 1948 u krijua në Tiranë Muzeu Arkeologjik-Etnografik, më pas u krijua Sektori Shkencor i Kërkimeve Arkeologjike, nga i cili më 1976 u formua Qendra e Studimeve Arkeologjike dhe më 1991 Instituti i Arkeologjisë. Gjatë këtyre viteve, veç Muzeut qendror Arkeologjik dhe paviionit arkeologjik në Muzeun Historik Kombëtar, u ngritën edhe muze të profilit arkeologjik në Durrës, Apoloni, Butrint dhe Korçë, të cilët ruajnë objekte me vlera unike.

Vitet 1991-1999 përbëjnë një etapë të re për arkeologjinë shqiptare, atë të bashkëpunimit me arkeologë të huaj. Janë realizuar ose vazhdojnë veprimtarinë projekti shqiptaro-grek në Butrint, projekti shqiptaro-amerikan në Shpellën e Konispolit (Sarandë) dhe në zonën Apoloni-Bylis, projekti shqiptaro-francez në Apoloni dhe në vendbanimin prehistorik të Sovjanit (Korçë) dhe projekti shqiptaro-anglez në Butrint. Gjatë vitit 2000 janë duke u hartuar edhe projekte të tjera për kërkime në Durrës, Bylis e qendra të tjera arkeologjike.

Rezultatet e kërkimeve, gërmimeve e studimeve arkeologjike, më se njëqindvjeçare, të bëra në Shqipëri, mund t'i përmbledhim në:

Në fushën e prehistorisë

Gjurmët më të hershme të banimit të territorit të Shqipërisë janë zbuluar në Xarë (Sarandë) dhe në Gajtan (Shkodër) të cilat i takojnë epokës së paleolitit (rreth 100 000 vjet më parë). Periudhës së paleolitit të vonë (30 000-10 000) vjet, i takojnë një numër më i madh vendbanimesh (Xarë, Konispol, Shën Marinë, Kryegjatë, Rrëzë Dajti, Gajtan etj.), të cilat mbulojnë gjithë territorin e Shqipërisë së sotme.

Gjatë epokës së neolitit (7000-3000 p.e.s.) territori i vendit tonë ka qenë shumë më i banuar, gjë që e dëshmojnë me dhjetëra vendbanime të zbuluara, të cilat kanë qenë ngritur në fusha pjellore, në tarraca lumore dhe në shpella. Banesat e tyre ishin kasolle të thjeshta të liera dhe të shtruara me baltë. Në Dunavec e Maliq janë zbuluar banesa të ngritura mbi hunj (palafite), të cilat kërkonin një teknikë të lartë të ndërtimit të banesave. Por në jetën e banorëve neolitikë vend qendror zinte bujqësia dhe blegtoia si edhe përgatitja e prodhimi i enëve prej balte. Nga fundi i epokës neolitike mjeshtrit e punimit të poçarisë arrijnë të prodhojnë jo vetëm enë cilësore e me forma të shumë-llojshme, por edhe me vlera artistike.

Vlerë të veçantë kanë disa enë të pikturuara të gjetura në Dunavec, Cakran e Maliq, të cilat janë të importuara nga kulturat e Diminit në Thesali (Greqi). Ato janë dëshmitë e para të këmbimit midis trevave të vendit tonë me qytetërimet më të përparuara të Europës Jug-Lindore të epokës neolitike.

Në fillim të epokës së metaleve (mijëvjeçari i tretë p.e.s.) në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik ndodhën ndryshime të rëndësishme si rezultat i dyndjes së popujve baritor, indoevropian, të ardhur nga lindja. Një shfaqje e re ishte kulti i varrimit në tuma (Pazhok të Elbasanit, Barçë të Korçës, Piskovë të Përmetit etj.). Ky rrit varrimin në tuma do të përdoret pa ndërprerje gjatë tërë epokës së bronzit dhe do të bëhet karakteristik për



popullsinë ilire të epokës së hekurit.

Nga fundi i mijëvjeçarit të dytë dhe gjatë tërë gjysmës së parë të mijëvjeçarit të parë p.e.s., ilirët fillojnë dhe i vendosin vendbanimet e tyre në kodra të ngritura me pozicion dominues mbi zonën përreth, dhe gradualisht (i përforcjnë) i rrethojnë me mure të fuqishme (Gajtan-Shkodër, Tren-Korçë, Kalivo-Sarandë etj.).


Në fushën e antikitetit

Deri në shek. VII p.e.s. trevat e ndryshme ilire kishin përparuar pothuajse me të njëjtin ritëm. Midis tyre dalloheshin disa krahina të veçanta si Fusha e Korçës, Mati, Glasinaci (në Bosnjë) etj., të cilat kishin arritur të krijojnë një kulturë materiale me nivel më të lartë se të tjerat. Përfshirja e Ilirisë në lëvizjen e gjerë ekonomike-shoqërore mesdhetare, bëri që pas shek. VII p.e.s. të dalin në radhë të parë të zhvillimit trevat jugore ilire - Iliria e Jugut.

Faktor parësor u bënë marrëdhëniet e hershme me botën greke dhe veçanërisht procesi i urbanizimit u përshpejta me themelimin e kolonive greke në brigjet e Ilirisë. Kështu kolonistë të ardhur nga Korkyra më 627 p.e.s. themeluan Dyrrahun dhe më 588 p.e.s. theme-luan Apoloninë.

Rreth gjysmës së parë të shek. VI themelohet dhe Oriku. Të dhënat arkeologjike dëshmojnë se gjatë shek. VI-V Dyrrahu e Apolonia kthehen në qytete të mirëfillta, kurse gjatë shek. IV ato njohën një lulëzim të përgjithshëm që u shpreh me ndërtime monumentesh madhështore.

DYRRAHU ose Epidamni, qysh në shek. V p.e.s. kishte punishte të punimit të qeramikës, të metaleve, të pëlhurave e lëkurës,



kan tier për ndërtimin e anijeve etj. Dëshmi e zhvillimit të tregtisë janë monedhat prej bronzit e argjendi që pret Dyrrahu, kurse për lulëzimin urbanistik të shek. IV p.e.s. dëshmon mozaiku i një dysHEMEJE me gurë lumi, i ashtuquajtur Bukuroshja e Durrësit.

Në vitin 229 p.e.s. Dyrrahu kaloi në vartësi të Romës dhe më vonë u kthye në koloni romake. Në shek. I-III përjeton një periudhë lulëzimi, u bë qendër dhe porti kryesor i brigjeve të Adriatikut lindor. Kësaj kohe i takon ndërtimi i amfiteatrit, i termave, bibliotekës, ujësjellësit etj.

Në shek. IV Dyrrahu bie ekonomikisht dhe tërmeti i vitit 345. e rrënon edhe më tej, duke e bërë të kthehet në një qendër të vogël tregtare. Pozita e tij gjeografike e bëri Dyrrahun që gjatë shek. V-VI ai të kthehet në një nga qytetet e rëndësishme të perandorisë bizantine. Në kohën e perandorit Anastas (me origjinë nga Durrësi) u ndërtuan shumë godina të reja, hipodromi dhe tre radhë muresh rrethues shumë të fuqishëm.

Qytet antik ndër më të mëdhenjtë në pellgun e Adriatikut dhe më i përmenduri ndër 30 qytetet e tjera me të njëjtin emër të kohës antike. U ngrit mbi një kodër (me dy maja të larta 101 e 103m mbi nivelin e detit) me një pozicion që zotëron tërë zonën dhe nëpërmjet luginës së lumit Aqos (Vjosë) lidhej me detin Adriatik. Në shekujt e parë të jetës, Apolonia mbante lidhje të ngushta me Korinthin dhe Korkyrën dhe luante rolin e ndërmjetësit në tregtinë e helenëve me ilirët. Në shek. V p.e.s. u bë qendër e zhvilluar ekonomike me punishte të shumta zejtare, zgjeroi marrëdhëniet me botën ilire si edhe me Atikën e më vonë edhe me Magna Grecian (Italinë e Jugut).

Lulëzimin më të madh qyteti e njohu në shek. IV-III p.e.s. Në këtë kohë qyteti u shtri në të gjithë faqen perëndimore të kodrës dhe u rrethua me një mur mbrojtës 4km të gjatë duke përfshirë një hapësirë të qytetit prej 138 ha. Apolonia u ndërtua sipas një plani që mbështetej në sistemin ortogonal të Hipodamit; përshkohej nga rrugë të drejta, kryesore e dytësore, që kryqëzoheshin me njëra-tjetrën, duke kufizuar lagje të veçanta. Nga ndërtimet kryesore veç mureve rrethuese u ndërtua portiku i qendrës së qytetit (agorasë),

teatri, një çezmë monumentale, gjimnazi etj. Shëtitoretja e Apolonisë shquhet për planimetrinë e zhvilluar dhe arkitekturën solide. Ajo është me dy kalime dhe dy kate (70.2x10.50m). Muri i pasmë, që ka një rol mbajtës, është me 17 kamare obsidale, ku vendoseshin shtatoret, kolonada e brendshme dhe e jashtme e katit të parë formohej nga kolona tetë këndore. Në shek. I-III qyteti përjetoi një periudhë të dytë ndërtimesh intensive, si tempullin e Agonotetëve, odeonin, bibliotekën dhe një sërë vilash të zbuluara me mozaikë. Apolonia në kohën e Augustit u shpall qytet i lirë dhe i paprekshëm dhe vazhdoi të mbetej një qendër e rëndësishme ekonomike e kulturore. Lulëzoi arkitektura dhe degë të tjera të artit, e sidomos skulptura. Ndaj me të drejtë Ciceroni e quajti “Magna urbs et gravis” (qytet i madh e hije rëndë).

Në shek. III-IV qyteti humbet rëndësinë e dikurshme dhe në fillimet e mesjetës.

Apolonia kthehet në një qendër peshkopale


Marrëdhëniet e ndërsjella të qyteteve koloni me interlandin ilir shpejtuuan procesin e lindjes dhe zhvillimit të një tog qytetesh ilire. Gjatë shek. IV-II p.e.s. ngrihen qytete si Butrinti, Amantia, Bylisi, Foinike, Antigonea, Dimali, Lisi etj. Ato ishin vendosur mbi maja apo shpate kodrash, me horizont të gjerë shikimi dhe të rrethuara me mure me konstruksione solide me blloqe gurësh të skalitur me

forma trapezoide, poligonale e në një fazë më të zhvilluar me blloqe kuadratikë. Në shek. IV p.e.s. ato ishin kthyer në qendra zejtare e tregtare, kurse rreth mesit të shek. III p.e.s. qyteti ilir ishte formuar me tiparet themelore të një qyteti antik. Hapësira e brendshme e qytetit ishte e organizuar sipas sistemit hipodamik, ku agoraja në të cilën ishin vendosur godinat e karakterit politik e shoqëror, kulturor e religjioz (prytaneioni, teatri, shëtitoretja, tempujt etj) formonin qendrën e qytetit të ndarë nga pjesa tjetër. Disa shembuj të këtyre ndërtimeve në qytetet ilire e dëshmojnë më së miri nivelin urbanistik të tyre.

BUTRINTI. Të dhënat arkeologjike dëshmojnë se në shek. VII-VI p.e.s. Butrinti ishte një qendër protourbane, kurse në shek. V p.e.s. arriti të marrë tiparet e plota të një qyteti. Në fund të shek. IV fillim i shek. III p.e.s. u ndërtua agoraja e qytetit, një portik (shëtitore), një tempull i vogël dhe teatri me 1500 vende i cili është ruajtur i plotë deri në ditët tona. Ai bashkë me ndërtimet e tjera pranë, si tempullin e Asklepit, portikun, banjat etj., përbënin pjesën më të bukur të qytetit antik.

Në periudhën e vonë antike e mesjetës së hershme Butrinti përjetoi një periudhë lulëzimi. Kësaj kohe i takon ndërtimi i Baptisterit i cili është monumenti më i rëndësishëm i periudhës paleokristiane. Salla e pagëzimit në formë rrethore me diametër 13.50m është shtruar me mozaikë shumëngjyrësh, me motive nga bota shtazore e figura gjeometrike, të cilat kanë vlerë të veçantë artistike. Salla përshkohet nga dy radhë kolonash granite mbi të cilat kanë qenë mbështetur qemerët e çatia.

ANTIGONEA. Qytet i themeluar në shek. III p.e.s. me një mur 4000m të gjatë, është ndërtuar me një sistem urbanistik të tipit hipodamik, me rrugë të drejta e të kryqëzuara që



ndajnë qytetin në insula me gjerësi 200 këmbë dhe në ndarje të tjera më të vogla.

AMANTIA. Është e vendosur në faqen e një kodre të lartë dhe kishte të fortifikuar me një mur të gjatë 2200m, vetëm akropolin. Emri i qytetit për herë të parë përmendet në shek. IV p.e.s.. Në shek. III p.e.s. qyteti fuqizohet ekonomikisht dhe arrin të presë monedhat e veta. Këtë e dëshmojnë ndërtimi i tempullit të Afërditës, rrënojat e një teatri dhe veçanërisht ndërtimi i stadiumit, i cili është ruajtur i plotë deri në ditët tona. Stadiumi ka formën tipike të stadimeve greke me dy krahët e gjata që kufizojnë pistën me gjatësi 184.8m dhe gjerësi 12.25m. Njëri krah i shkallares i ndërtuar me blloqe gurësh gëlqerorë ka 17 radhë, kurse krahut tjetër ka 8 radhë.

BYLISI. Një nga qytetet më të mëdha ilire u zhvillua në shek. IV p.e.s. si kryeqendër e fisit ilir të bylinëve. Ai kishte një sipërfaqe prej 30ha të rrethuar me mur të mbrojtur nga 7 hyrje e 7 kulla. Në shek. III p.e.s. qyteti u fuqizua ekonomikisht, kohë kur ndërtohet agoraja (qendra e qytetit) prej 4ha, ku ngrihet teatri me rreth 9000 vende, stadiumi, gjimnazi etj. Në shek. I Bylisi u kthye në koloni romake.

Në shek. IV qyteti rrethohet me mure të fuqishme, dhe më pas në shek. V-VI u bë një qendër e rëndësishme peshkopale. Për këtë flet zbulimi i gjashtë bazilikave, dyshemetë e të cilave janë shtruar me mozaikë me motive paleokristiane të një cilësie të lartë.

ALBANOPOLI. Qytet ilir, qendër e fisit të Albanëve, që përmendet për herë të parë në mesin e shek. II nga Ptolemeu, i cili përcakton dhe koordinatat e shtrirjes së tij. Është lokalizuar me rrënojat e qytetit ilir të Zgërdheshit (në afërsi të Krugës). Emri i qytetit dhe i fisit të albanëve që krijuan atë, u ruajt në mesjetë e deri në ditët tona duke i dhënë emrin gjithë trevës ku shtriheshin Ilirët e Jugut - Albania.

LISI. U formua si qytet nga fundi i shek. IV p.e.s. mbi bazën e një vendbanimi protour-

ban. Në shek. III-II p.e.s. muret rrethuese e ndanin atë në tre pjesë, akropolin, qytetin e sipërm dhe qytetin e poshtëm që shtrihet buzë lumit Drin. Muret e qytetit janë të ruajtur shumë mirë me 12 portat dhe kullat e shumta që i japin një pamje madhështore qytetit. Lisi në kohën e Cezarit merr të drejta dhe ofiqe municipale dhe luan një rol aktiv në luftën civile midis Pompeut e Cezarit.

SELCA E POSHTME. Në kodrat e fshatit me të njëjtin emër, janë zbuluar rrënojat e një qyteti ilir të shek. IV-III p.e.s. Në shek. III bëhet qendër e krahinës ilire të Dasareteve. Në këtë kohë gdhenden në shkëmb 4 varre monumentale princërorë, me një arkitekturë të stilit jonik. Në njërin varr është gjetur një inventar shumë i pasur me armë, enë bronzit e balte, zbulurime ari dhe një pafitë metalike me skenë mitologjike luftimi.

Në qytetet koloni, Dyrrah, Apoloni si edhe në qytetet e tjera të Ilirisë së Jugut si në Butrint, Amantia, Bylis, Antigone etj., krahas degëve të ekonomisë u zhvillua e lulëzoi arti, i cili në fillim zhvillohet i lidhur me traditën e metropoleve (korinthase e korkyrase). Pas shek. V krahas vazhdimit të traditës, arti fiton veçori lokale. Vlera të veçanta artistike kanë punimet në qeramikë. Në shek. IV-III p.e.s. punishtet e Apolonisë e Dyrrahut prodhuan enë me figura të kuqe me tema mitologjike dhe nga jeta e përditshme. Figurinat (terakotat) e shumta me tema mitologjike e më pas edhe tema nga jeta e përditshme, dallojnë për plastikën e realizimin artistik. Krahas terakotave të shumta janë edhe figurinat prej bronzit, mjaft prej të cilave përbëjnë vepra arti

Gjatë shek. I-II në skulpturë përvetësohen tiparet e artit romak. Veçanërisht në skulpturë portreti ndjek realizimin tipik të kohës me një frymë të mbështetur

në traditën. Qendra kryesore është Apolonia me portretet e magjistratëve, të Filozofit, të Bilias etj. Portrete cilësore të shek. I-II kanë dhënë Dyrrahu, Butroti, Foinike etj. Relievi bëhet skematik dhe lidhet me qëllimet praktike të zbulurimit të altarëve, sarkofagëve, monumenteve arkitektonike etj.

Mozaiku, si gjini e pikturës monumentale dekorative në kohën antike (greko-romake) dhe atë mesjetare të hershme, njohu një lulëzim të dukshëm, sidomos në shekujt e parë. Duke përdorur gurë kubik të zinj ose shumëngjyrësh të vendosur në sfond të bardhë u arrit të realizoheshin figura të ndryshme gjeometrike dhe skena nga mitologjia detare. Shquhet mozaiku polikrom zbuluar në Apoloni, që paraqet Luftën e amazonëve.

Mozaiku si vepër e artit lulëzon edhe në shek. V-VI realizuar në veprat e kultit paleobizantin, si në bazilika, kisha, pagëzimore, trikonka etj. Në dyshemetë e këtyre monumenteve figurat e mozaikut janë të shpërndara lirshëm në sipërfaqe dhe janë figura simetrike, kafshë në qetësi, pemë, fruta, bisqe hardhie, shpendë, peshq e motive të ndryshme ujore. Në radhën e këtyre realizimeve cilësor është mozaiku i Baptisterit të Butrintit, i trikonkës së bazilikës së Linit (Pogradeç), mozaiku u bazilikës së Arapajt (Durrës) i bazilikave të Bylisit e shumë të tjera.

Në Shqipëri është ruajtur deri në ditët tona vetëm një mozaik parietal (i vendosur në mur), ai është mozaiku i kapelës së Durrësit, i ngritur brenda amfiteatrit të qytetit. Ai paraqet figura shenjtorësh dhe i përket periudhës së hershme bizantine.

Në fushën e mesjetës së hershme

Gjatë shekujve të mesjetës së hershme shqiptare shek. VII-IX ka një braktisje të qyteteve për shkak të kthimit në ekonominë e mbyllur natyrore. Vetëm Durrësi, ku u kufizua pushteti bizantin, e ruajti karakterin e mirëfilltë qytetar. Gjithashtu edhe Butrinti, në jug, mbeti qendër e rëndësishme qytetare.

Një ringjallje e jetës qytetare vihet re pas shek. IX kur fillon qarkullimi i monedhave bizantine. Ndër qytetet e ringjallura mbi truallin e qyteteve ilire, në këtë periudhë janë Berati, Kanina, Lezha, ndërtimet fortifikuese (muret, portet e kullat) të tyre janë ruajtur deri në ditët tona.

Nga vijnë sot rreziqet që sjell ndërthurja e progresit teknologjik dhe aktiviteteve ushtarake?

...vijon nga numri i kaluar

Para së gjithash nga i ashtuquajtur i përdorim i dyfishtë, ky nuk është një fenomen i ri, siç e kemi parë në shembujt e mëparshëm, por prania e teknologjive të reja e ka bërë veçanërisht dramatike: në fakt, shumë prej tyre mund të kenë përdorime civile dhe ushtarake dhe është e vështirë të përcaktohen kufijtë të saktë. Dhe problemi ka të bëjë jo vetëm me aplikimet e padëshiruara ushtarake të kërkimeve të kryera për qëllime të tjera, por gjithashtu dhe mbi të gjitha kërkimet që synojnë në mënyrë eksplicite aktivitetet ushtarake: për shembull, përpjekjet e mëdha synojnë në mënyrë eksplicite krijimin dhe përmirësimin e llojeve të reja të armëve konvencionale, ato të cilat quhen “armë inteligjente”.

Rrëfimet gazetareske të luftërave të fundit, në fakt na kanë mësuar të dëshmojmë përdorimin e tyre, dhe për fat të keq ata na kanë mësuar gjithashtu me faktin se inteligjenca e tyre e supozuar mbetet në fund të fundit mjaft e kufizuar. Më konkretisht, rreziqet e prodhuara nga zhvillimi i kërkimit ushtarak janë të lidhura me përhapjen e WMD (armët e shkatërrimit në masë) dhe në veçanti të armëve bërthamore. Përhapja ka dy aspekte: flasin për përhapje vertikale në kuptimin e rritjes dhe modernizimit të arsenalet të vendeve që tashmë kanë armë bërthamore; nga ana tjetër, flitet për përhapje horizontale në kuptimin e hyrjes së anëtarëve të rinj në grupin e vendeve me armë bërthamore. Zakonisht në këtë fazë historike priremi të nxjerrim në pah mbi të gjitha rreziqet e përhapjes horizontale (Iraku, Koreja e Veriut, Irani janë raste shumë aktuale), por nuk duhet të harrojmë se edhe përhapja vertikale është një problem serioz.

Jo vetëm që dobëson regjimin ndërkombëtar të mospërhapjes, pasi NPT (Traktati i Mospërhapjes) parashikon që shtetet që kanë armë bërthamore pakësojnë, në vend që të rrisin, arsenalet e tyre. Por duhet theksuar gjithashtu se kërkimet në këtë fushë prodhojnë lloje të reja të armëve bërthamore të miniaturës që duken “më të përdorshme”, dhe për këtë arsye ulin pragun për përdorimin e armëve bërthamore në fushën e betejës. Një mundësi që do të ishte e arsyeshme të hiqej, duke kufizuar përdorimin e armëve bërthamore në një parandalim të pastër. Sot flitet shumë edhe për terrorizmin bërthamor: një nënprodukt i dukshëm i disponueshmërisë së materialeve të rrezikshme dhe i situatave të pasigurta të krijuara nga ndryshimet e pesëmbëdhjetë viteve të fundit. Kjo formë ekstreme e terrorizmit - për momentin, për fat të mirë, vetëm hipotetike - paraqitet me variante të ndryshme të mundshme, jo të gjitha njësoj të mundshme: vjedhja dhe përdorimi i bombave të para-paketuara; prodhimi i një bombe rudimentare; dhe në fund përdorimi i të ashtuquajturës bombë të pistë. Në rastin e parë, vështirësia për terroristët qëndron në faktin se nuk mjafton të kesh një kokë lufte: duhet të dihen edhe procedurat për aktivizimin e saj dhe këto janë mjaft të ndërlikuara dhe mbahen mirë sekret. Rasti i tretë është në një farë mënyre më pak dramatik: shpërthimi i një bombe konvencionale të ndotur me materiale radioaktive sigurisht që do të kishte një ndikim shumë serioz psikologjik dhe ekonomik, por efektet e tij materiale nuk do të ishin nga distanca të krahasueshme me ato të një bombe të vërtetë bërthamore. Rasti i dytë është në një farë kuptimi më shqetësues, sepse e vetmja vështirësi reale qëndron në marrjen e një sasive të mjaftueshme të uranimit të pasuruar (HEU, uranum i pasuruar shumë), pasi mekanizmi i ndezjes së pajisjes mund të jetë gjithashtu relativisht rudimentar. Prodhimi i HEU, sigurisht, nuk është diçka që të gjithë mund ta përballojnë, por materiali gjithashtu mund të vhidet ose blihet në ndonjë treg të zi. Prandaj, problemi kryesor duket të jetë ai i qarkullimit të HEU-ve: kjo e bën problematike edhe përhapjen e

teknologjive bërthamore civile. Në fakt, një cikël prodhimi i karburantit bërthamor për termocentralet civile mund të shndërrohet lehtësisht në një cikël prodhimi të HEU-ve për bomba: një shembull tjetër dramatik i lidhjes midis teknologjive civile dhe bërthamore. Në çështjen e terrorizmit bërthamor, vëmendja duhet mbajtur sigurisht lart, por shmangni dorëzimin ndaj alarmimit. Në fakt, duhet të pyesim veten nëse mjete të tilla të ndërlikuara përdorimi janë vërtet interesante për terroristët. Në fund të fundit, ekziston një element i bllofit në terrorizëm, i cili padyshim synon të nxisë frikë të pakontrollueshme: paniku është pikërisht një nga objektivat. Nga ana tjetër, vitet e fundit është demonstruar gjerësisht se dëme të mëdha - materiale, njerëzore, ekonomike dhe psikologjike - mund të shkaktohen edhe pa armë bërthamore: mjafton të dimë të përdorim dobësitë e natyrshme në mënyrën tonë moderne të jetesës. Së fundi, përdorimi i ADM-ve (përfshirë ato kimike dhe biologjike) nuk është aq i thjeshtë sa mund të imagjinohet: mjafton të kujtojmë se sektori japonez Aum Shinrikyo, i cili në 1995 filloi një sulm kimik në metronë e Tokios (12 vdekje), filloi në vitin 1993 të përpjetej të merrte armë bërthamore, por nuk ia doli kurrë, pavarësisht se kishte para, aftësi teknike, hapësirë për të punuar dhe madje edhe një minierë private uranumi. Pra, a është ky një kërcënim i ekzagjeruar? Vështirë të thuash. Problemi kryesor duket të jetë kontrabanda e HEU dhe jo transferimi vullnetar i bombave ose materialeve nga qeveritë: në fund të fundit, edhe “shtetet mashtrues” nuk kanë interes të heqin dorë nga kontrolli i armëve të ngjashme dhe në histori nuk ka pasur kurrë një rast të ngjashëm. Ka ndodhur, siç ndodh shpesh në këto raste, që rreziqet kryesore burojnë nga moszgjidhja e konflikteve që tronditin epokën tonë: nuk mund të reduktojmë gjithçka në aspektin teknik apo ushtarak. Kjo padyshim nuk e zvogëlon përgjegjësinë e shkencëtarëve që janë të përfshirë në aktivitete ushtarake; më tepër thekson faktin se shkencëtarët duhet dhe mund të kontribuojnë gjithashtu në zgjidhjen e konflikteve.

Tashmë është e nevojshme të jepen disa informacione më të detajuara për lidhjen midis shkencës dhe fuqisë ushtarake, dhe më saktë për marrëdhëniet midis kërkimit shkencor dhe kërkimit ushtarak. Në përgjithësi, kërkimi shkencor i natyrës ushtarake luan një rol kryesor. Nuk ka asnjë sektor tjetër të kërkimit shkencor në vendet më të industrializuara ku ndërhyrja e shtetit të ketë peshë më të madhe. Megjithatë, efektet e kërkimit shkencor ushtarak janë të shumëfishta dhe ndikimi i tij në ekonomi është veçanërisht i rëndësishëm. Shenja e këtij ndikimi është e paqartë. Ka shembuj të panumërt të një efekti stimulues në inovacionin teknologjik dhe për rrjedhojë në rritjen e produktivitetit. Nga ana tjetër, shtrëmbërimet e shkaktuara nga mbajtja e një aparati shkencor-ushtarak të përmasave

të konsiderueshme krijojnë pasoja negative të gjera: militarizimin e politikës së jashtme, konsolidimin e presionit dhe grupeve të pushtetit që ndryshojnë funksionimin e institucioneve demokratike.

